



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:023850
Datë: 31.07.2018
Numri i dokumentit: 00103668

P.nr.81/2016

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Vjollca Buzhala me bashkëpunëtorin profesional Hilmi Elshani, në çështjen penale kundër të akuzuares F. E. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamentit të Përgjithshëm nën numrin PP/IL.nr.1386/2015 të datës 19.01.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren M. K. dhe të akuzuares, me datë 31.07.2018 publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

F. E. nga i ati A., e lindur më datë 20.08.1950 në Prizren, rrugën ... nr..., me numër personal shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Prej datës së pavërtetuar e deri më datën 14.03.2015, në Prizren, në rr. ... nr..., pikërisht në shtëpinë e saj, merr, përdor, devijon, nxjerr ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose përmes mjetit përçues të rrymës apo rjetit të shpërndarjes, pa autorizim e furnizuesit të autorizuar, bënë shfrytëzimin e energjisë elektrike me njehsor nr.2624982, i cili bllobat shtetërore i ka të falsifikuar në brendi, numruesi i njehsorit është i manipuluar ka gjurmë të gërvishtjs së numrave në numrator, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material.

Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 nënpar. 1.1, 50, 51, 52, 73, nenit 320 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit ia shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që vërteton

- dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

- dënimin me gjobë në lartësi prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara KEDS-Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet e akuzuara F. E., që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 euro si dhe për kompenzimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1386/2015 të datës 19.01.2016, kundër të akuzuares F. E. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Gjykata në shqyrtimin kryesor në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuares. E akuzuara pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se prej datës së pavërtetuar gjer më datën 14.03.2015, në shtëpinë e saj familjare e cila gjendet në Prizren, e akuzuara F. E. me shifër të konsumatorit 3403, gjatë ndërrimit të orës nga ana e zyrtarëve të KEDS – Distribucioni në Prizren, është vërtetuar se e akuzuara ka shfrytëzuar energjinë elektrike me numër njëhisorit 2624982, i cili blloibat shtetërore i ka të falsifikuar, në brendi numruesi i njëhisorit është i manipuluar ka gjurmë të gërvishitjes së numrave në numrator, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike ka vërtetuar nga pranimit vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuares për veprimet e saj të përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën

penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast e akuzuara prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuares është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e saj formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuaren ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, është në moshë të shtyer, pensioniste, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së saj dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën e akuzuara është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për kërkesën pasurore juridike në kontest civil, është marrë konform nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale është marrur në kuptim të nenit 453 par. 4 të KPP-së.

Vendimin në emër të programit për kompenzimin e viktimave është marrë në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 të ligjit 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:023850, 31.07.2018

G j y q t a r i

Vjollca Buzhala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.